

B a n k a e S h q i p ë r i s ë

2 0 0 0 6

BULETINI  
I BILANCIT TË PAGESAVE

Nëse përdorni të dhëna të këtij publikimi, jeni të lutur të citoni burimin.  
Botuar nga: Banka e Shqipërisë, Sheshi "Skënderbej", Nr. 1, Tiranë.  
Tel: 355-4-222230; 235568; 235569;  
Faks: 355-4-223558  
e-mail: [public@bankofalbania.org](mailto:public@bankofalbania.org)

[www.bankofalbania.org](http://www.bankofalbania.org)

Për informacione lidhur me këtë publikim, lutemi kontaktoni:  
Sektori i Botimeve, Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integritet Evropian dhe  
Komunikimit.  
E-mail: [public@bankofalbania.org](mailto:public@bankofalbania.org)

Shtypur në Shtypshkronjën e Bankës së Shqipërisë.  
Tirazhi: 1200 kopje

# P Ë R M B A J T J A

1.	ZHVILLIME TË PËRGJITHSHME NË BILANCIN E PAGESAVE GJATË VITIT 2006	7
1.1	TREGUES TË SEKTORIT TË JASHTËM	9
1.2	LLOGARIA KORENTE	10
1.3	LLOGARIA KAPITALE DHE FINANCIARE	22
1.4	REZERVAT VALUTORE	25
2.	ANEKS	26
2.1	POLITIKA TREGTARE TË SHQIPËRISË	26
2.2	ANALIZA E VROJTIMIT TË TURIZMIT PËR VITIN 2006	28
3.	ANEKS METODOLOGJIK	34
4.	ANEKS STATISTIKOR	37

P Ë R M B A J T J A E T A B E L A V E

1. Zhvillime të përgjithshme në bilancin e pagesave gjatë vitit 2006	
Tabelë 1. Treguesit kryesorë të bilancit të pagesave në raport ndaj PBB-së.	9
Tabelë 2. Tregtia e mallrave.	11
Tabelë 3. Eksporti sipas klasifikimit SITC.	12
Tabelë 4. Importi sipas klasifikimit SITC.	13
Tabelë 5. Shpërndarja e eksporteve sipas partnerëve tregtarë në vite.	17
Tabelë 6. Shpërndarja e importeve sipas partnerëve tregtarë në vite.	17
Tabelë 7. Struktura e importit dhe eksportit të shërbimeve.	19
2. Aneks	
Tabelë 1. Shpërndarja e jorezidentëve sipas shteteve në vite dhe ndryshimi vjetor për vitin 2006 (në përqindje).	30

## P Ë R M B A J T J A E G R A F I K Ë V E

1. Zhvillime të përgjithshme në bilancin e pagesave gjatë vitit 2006	
Grafik 1.	Deficiti korent në përqindje ndaj PBB-së. 7
Grafik 2.	Shpërndarja e të ardhurave dhe e shpenzimeve në llogarinë korente. 10
Grafik 3.	Divergjenca në eksporte dhe importe (ritmet e rritjes vjetore). 11
Grafik 1, boks 1.	Ecuria e lëndëve djegëse në vite. 14
Grafik 1, boks 2.	Kontributi në ndryshimin e totalit të importeve. 15
Grafik 4.	Kontributi i tregtisë nga përpunimi aktiv në vëllimin e përgjithshëm tregtar (importe+eksporte në milionë usd). 16
Grafik 5.	Bilanci i shërbimeve - fluksi neto në milionë euro. 18
Grafik 6.	Rritja vjetore në importe dhe eksporte shërbimesh. 18
Grafik 7.	Ecuria e eksportit të mallrave dhe e rritjes relative të eksportit udhëtime/mallra. 19
Grafik 8.	Shpenzimet për turizëm ndaj fluksit hyrës të remitançave. 20
Grafik 9.	Bilanci i të ardhurave (në milionë euro). 21
Grafik 10.	Ecuria e dërgesave të emigrantëve (në milionë euro). 22
Grafik 11.	Llogaria financiare në vite – fluksi neto në milionë euro. 22
Grafik 12.	Financimi i deficitit korent nëpërmjet investimeve të huaja direkte. 23
Grafik 13.	Rezerva valutore në muaj importe. 25
2. Aneks	
Grafik 1.	Ecuria e rritjes vjetore të numrit të jorezidentëve dhe rezidentëve në tremujorë. 29
Grafik 2.	Shpërndarja e rezidentëve dhe jorezidentëve sipas shteteve. 29
Grafik 3.	Shpërndarja e rezidentëve dhe jorezidentëve sipas qëllimit të udhëtimit. 30
Grafik 4.	Shpërndarja e udhëtarëve rezidentë dhe jorezidentë sipas mënyrës së udhëtimit. 31
Grafik 5.	Ditëqëndrimi mesatar për rezidentët dhe jorezidentët sipas qëllimit të udhëtimit dhe sipas tremujorëve 2004-2006. 31
Grafik 6.	Shpenzimet mesatare ditore për rezidentët dhe jorezidentët sipas qëllimit të udhëtimit dhe sipas tremujorëve 2004-2006. 32
Grafik 7.	Struktura e shpenzimeve të kryera nga rezidentët dhe jorezidentët. 32



## 1. ZHVILLIME TË PËRGJITHSHME NË BILANCIN E PAGESAVE GJATË VITIT 2006

Sektori i jashtëm i ekonomisë, gjatë vitit 2006, paraqitet me një bilanc negativ në llogarinë korente, shkaktuar kryesisht nga një deficit i lartë tregtar. Flukset hyrëse në kapitale kanë qenë të mjaftueshme për kompensimin e deficitit korent, duke mundësuar një bilanc të përgjithshëm pozitiv në nivelin 207 milionë euro.

Treguesi relativ i deficitit korent ndaj PBB-së, vlerësohet në rreth 7.3 për qind dhe ka ruajtur të njëjtin nivel të vitit të mëparshëm.


Deficiti tregtar ka përbërë një tipar të përhershëm të zhvillimeve të tregtisë së jashtme, duke diktuar nivelet e larta të deficitit të llogarisë korente. Kërkesa e lartë për importe, për nevoja të rritjes ekonomike dhe njëkohësisht për të plotësuar nevojat e popullsisë në mallra konsumi, ka evidentuar dukshëm zgjerimin e bazës së importeve në vite. Kjo dinamikë në importe nuk është pasuar me fuqizimin e eksporteve, duke bërë që hendeku tregtar të thellohet dhe të përbëjë faktorin kryesor për deficite të larta korente.

Për vitin 2006, rritja e importeve është bashkërrjedhojë e disa faktorëve të jashtëm – rritja e pazakontë e çmimeve të naftës si dhe rritja e çmimeve të disa mallrave në tregjet ndërkombëtare – dhe faktorëve të brendshëm – situata e përkeqësuar energjitike në vend, e cila çoi në importe të larta në energji elektrike.

Treguesi relativ i importeve ndaj PBB-së, për vitin 2006 vlerësohet në rreth 31.8 për qind nga 29.8, në vitin 2005.

Kështu, gjatë këtij viti Shqipëria regjistroi deficitin tregtar më të lartë në vite, prej 1.7 milionë eurosh. Por, ai mund të kishte qenë akoma më i përkeqësuar pa progresin e eksporteve.

Ngadalësimi i eksporteve, i vërejtur gjatë vitit të kaluar - pasojë e rritjes së presioneve konkurrionale në industrinë - kyçe të eksporteve shqiptare (tekstile dhe këpucë), e hapjes së tregjeve evropiane drejt vendeve të Lindjes



së Largët (Kina, India) dhe Turqisë, shoqëruar kjo edhe me ngadalësimin e rritjes ekonomike në vendet partnere, si dhe me situatën e përkeqësuar në furnizimin me energji elektrike në vend - është recuperuar ndjeshëm gjatë këtij viti. Të ardhurat nga eksporti vlerësohen në rreth 8.7 për qind të PBB-së, që përfaqëson nivelin më të lartë të arritur në vite.

Hyrje të konsiderueshme në formën e transfertave korente në vite, kanë ndihmuar në zbutjen e deficitit të lartë tregtar, duke çuar në lehtësimin e pozicionit të bilancit të pagesave. Gjatë vitit 2006, fluksi neto i transfertave korente arriti në rreth 1 miliard euro, nga të cilat vlerësohet se rreth 93 për qind janë kontribut i emigracionit shqiptar. Dërgesat e emigrantëve për vitin 2006 vlerësohen në 935 milionë euro ose në rreth 12.8 për qind të PBB-së.

Nga ana tjetër, financimi i deficitit korent të këtij viti ka qenë plotësisht i mundur nëpërmjet flukseve hyrëse të kapitalit të huaj në formën e transfertave kapitale, si dhe flukseve financiare në formën e investimeve të huaja direkte dhe të huamarrjes me jashtë.

Këto flukse hyrëse të kapitalit bënë që bilanci i përgjithshëm i pagesave të mbyllet me suficit prej rreth 207 milionë eurosh nga 125 milionë euro, në vitin 2005. Suficiti në bilancin e përgjithshëm, ka çuar në rritje të rezervave valutore (të cilat në fund të vitit 2006 u vlerësuan në rreth 1.3 miliardë euro), si dhe gjithashtu shpjegon pjesërisht, qëndrueshmërinë e lekut gjatë vitit.

Ndonëse deficiti korent ka qenë i pranishëm përgjatë gjithë periudhës së tranzicionit, madhësia e tij gjatë dy viteve të fundit përbën një çështje që duhet të tërheqë vëmendjen. Megjithëse, rezervat e mjaftueshme valutore, rritja ekomomike dhe stabiliteti i përgjithshëm makroekonomik lejojnë të arsyetohet rreth këtij deficiti të lartë në një periudhë afatshkurtër, qëndrueshmëria e tij në afat të gjatë duhet konsideruar.

Për më tepër edhe në periudha afatshkurtra, parapëlqehet financimi i deficiteve kryesisht me burime të qëndrueshme afatgjata. Investimet e huaja direkte përbëjnë një burim - kyç financimi, duke marrë parasysh faktin që këto flukse janë të qëndrueshme dhe shpesh kontribuojnë në teknologji dhe aftësi drejtimi. Ndonëse gjatë periudhës së privatizimit Shqipëria ka tërhequr flukse të larta të investimeve të huaja direkte, treguesi relativ i tyre në PBB mbetet i ulët. Për vitin 2006, ky tregues vlerësohet në 3.6 për qind të PBB-së.

Financimi i deficitit të vazhdueshëm korent nëpërmjet huamarrjes me jashtë, ndonëse në periudha afatshkurtra lehtëson pozicionin e jashtëm të vendit, përgjithësisht trajtohet si një strategji me rrezik. Megjithatë, Shqipëria nuk është në prag të ballafaqimit me aftësi paguese të borxhit të jashtëm. Shërbimi i borxhit të jashtëm vlerësohet në nivele modeste. Për vitin 2006 ai u llogarit në rreth 4.1 për qind të totalit të eksporteve.

Në një periudhë afatshkurtër, vëmendja duhet të fokusohet në ngushtimin e deficitit korent dhe në financimin e tij nëpërmjet flukseve të qëndrueshme afatgjata.



Duke qenë se rritja e deficitit korent është kryesisht pasojë e rritjes së deficitit tregtar, pikërisht këtu është pikënisja për vendimmarrje të politikave.

Përfundimisht, deficieti korent mund të jetë akoma i qëndrueshëm për një periudhë afatshkurtër, megjithatë në afat të gjatë kjo qëndrueshmëri do të jetë e diskutueshme, nëse në përkrahjen e rritjes së eksporteve nuk do të ndërmerren reforma strukturore. Për një periudhë afatmesme, me përmirësimin e ambientit të biznesit, vëmendja përqendrohet në rritjen e investimeve të huaja dhe të brendshme, drejt aktiviteteve me orientim eksporti.

	2004	2005	2006	2004	2005	2006
	në milionë euro			në përqindje ndaj PBB-së		
Llogaria korente	(286.2)	(493.2)	(534.7)	(4.8)	(7.3)	(7.3)
Bilanci tregtar	(1,276.7)	(1,476.7)	(1,685.4)	(21.3)	(21.9)	(23.1)
Eksport	485.6	530.2	630.6	8.1	7.9	8.7
Import	(1,762.3)	(2,006.9)	(2,316.0)	(29.4)	(29.8)	(31.8)
Shërbime (neto)	(40.5)	(140.4)	(66.8)	(0.7)	(2.1)	(0.9)
Të ardhura (neto)	140.7	135.0	208.6	2.3	2.0	2.9
Transferta korente (neto)	890.3	988.9	1,008.9	14.8	14.7	13.9
Llogaria kapitale (neto)	422.9	441.2	552.1	7.0	6.5	7.6
Bilanci i përgjithshëm	233.7	125.1	206.6	3.9	1.9	2.8

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Tabelë 1. Treguesit kryesorë të bilancit të pagesave në raport ndaj PBB-së.

## 1.1 TREGUES TË SEKTORIT TË JASHTËM

Shumë tregues - kyç të bilancit të pagesave, dëshmojnë për përmirësim gjatë vitit 2006, ndonëse në tregues të tjerë shfaqen disa dobësi.

Shkalla e hapjes tregtare<sup>1</sup> të Shqipërisë është përmirësuar në 74 për qind nga 68 për qind në vitin e kaluar, ndonëse mbetet në nivele mjaft të ulëta në raport me ekonomitë e rajonit. Duke marrë parasysh lidhjen mes hapjes tregtare dhe rritjes ekonomike, rritja e hapjes tregtare të vendit është një zhvillim i mirëpritur. Megjithatë, një zhvillim i tillë do të ishte më inkurajues nëse do të buronte nga eksportet, përderisa kompanitë me orientim eksporti, të cilat përballohen me konkurrencën e fortë ndërkombëtare, janë shpesh më eficiente. Për fat të keq, këtë vit përmirësimi i këtij treguesi ka ardhur në masën më të madhe nga rritja e importeve.

Gjatë vitit 2006 eksporti (në mallra dhe shërbime) u rrit me rreth 22 për qind krahasimisht me një vit më parë. Shërbimi i borxhit të jashtëm vlerësohet në nivele modeste, duke arritur në rreth 4.1 për qind të totalit të eksporteve ose shumë poshtë nivelit prej 25 për qind, të konsideruar përgjithësisht si nivel kritik.

Roli i importeve në rritje të treguesit të hapjes tregtare është reflektuar, gjithashtu, në raportin e deficitit korent ndaj PBB-së, i cili mund të përdoret si instrument matës i qëndrueshmërisë së deficitit korent. Si pasojë e rritjes së madhe të importeve, ky raport është përkeqësuar gjatë dy viteve të fundit. Deficiti korent, pa transfertat zyrtare, ka shifrën 8 për qind.


Treguesi relativ i investimeve të huaja direkte ndaj PBB-së u vlerësua në 3.6 për qind, me një rritje të lehtë prej rreth 0.3 pikë përqindjeje kundrejt një viti më parë. Ky raport konsiderohet në nivele të ulta, gjithashtu krahasuar me ekonomitë e rajonit.

Së fundmi, një tregues kritik i sektorit të jashtëm është mjaftueshmëria e rezervave për shembull, raporti i mbulimit të importeve, që mat aftësinë e ekonomisë për të plotësuar nevojat e saj për importe (të mallrave dhe shërbimeve) përmes rezervave të saj. Për vitin 2006, ky raport vlerësohet në 4.5 muaj importe dhe përbën një nivel të kënaqshëm<sup>2</sup>.

## 1.2 LLOGARIA KORENTE

Viti 2006 është karakterizuar nga një aktivitet intensiv në sektorin e jashtëm, i shprehur në rritje të konsiderueshme të të ardhurave dhe të shpenzimeve korente. Vëllimi i transaksioneve korente është rritur me 15 për qind krahasuar me vitin 2005, duke shënuar një nivel prej 7 miliardë eurosh. Mëse 95 për qind e shpenzimeve korente kanë shkuar për blerje mallrash dhe shërbimesh. Rreth 35 për qind e të ardhurave korente kanë hyrë në formën e transfertave korente, ndërkohë që shërbimet dhe eksportet e mallrave kanë siguruar përkatësisht 37 për qind dhe 20 për qind të të ardhurave.

Grafik 2. Shpërndarja e të ardhurave dhe e shpenzimeve në llogarinë korente.



Deficiti korent për vitin 2006, u vlerësua në nivelin 535 milionë euro, me një rritje prej rreth 8 për qind kundrejt vitit 2005, duke qenë i barazvlefshëm me rreth 7.3 për qind të PBB-së. Deficiti i lartë tregtar që ka karakterizuar zhvillimet në sektorin e jashtëm të ekonomisë gjatë këtij viti, ka neutralizuar efektet pozitive të zvogëlimit të ndjeshëm të pozicionit deficit në llogarinë e shërbimeve si dhe rritjen e flukseve pozitive në të ardhurat faktoriale neto, duke mbetur shkaktari kryesor në thellimin e deficitit korent për këtë periudhë.

Megjithëse norma vjetore e rritjes të eksporteve (19 për qind) ishte më e lartë se ajo e importeve (15 për qind), vëllimi i lartë i këtyre të fundit bëri që deficitit tregtar të rritej me rreth 209 milionë euro ose me 14 për qind.

Llogaria e shërbimeve gjatë këtij viti ka regjistruar rritje si në kahun e të ardhurave, ashtu edhe në atë të shpenzimeve. Në krahasim me vitin 2005, të ardhurat janë rritur më shpejt sesa shpenzimet. Për rrjedhojë, rezultati neto i transaksioneve në shërbime ka çuar në zvogëlim të ndjeshëm të deficitit të kësaj llogarie, me rreth 75 milionë euro.

Bilanci pozitiv i hyrjeve korente në formën e transfertave dhe të të ardhurave, vlerësohet të jetë rreth 94 milionë euro më i lartë, krahasuar me vitin e kaluar.

Një zhvillim i tillë i dedikohet kryesisht rritjes së të ardhurave nga interesat mbi investimet e njësive rezidente jashtë.

### 1.2.1 TREGTIA E JASHTME

Marrëdhëniet tregtare, përbëjnë komponentin kryesor të shkëmbimeve tona korente me pjesën tjetër të botës. Gjatë këtij viti ato përfaqësuan 43 për qind të tyre, duke regjistruar një vëllim të përgjithshëm tregtar prej 2.9 milionë eurosh.

Rritja vjetore me 410 milionë euro ose 16 për qind, vlerësohet të jetë 1.5 herë më e lartë se ajo e vitit të kaluar.

	Njësia	2004	2005	2006
Eksportet (FOB)	mln euro	485.6	530.2	630.7
Importet (CIF)	mln euro	1,830.5	2,083.9	2,410.9
Bilanci tregtar	mln euro	-1,344.9	-1,553.7	-1,780.2
Vëllimi tregtar	mln euro	2,316.1	2,614.0	3,041.7
Rritja e eksporteve (kundrejt vitit të mëparshëm)	%	22.9	9.2	19.0
Rritja e importeve (kundrejt vitit të mëparshëm)	%	11.7	13.8	15.7
Eksportet/PBB	%	8.1	7.9	9.0
Importet/PBB	%	30.5	30.9	34.4
Bilanci tregtar/PBB	%	-22.4	-23.1	-25.4
Shkalla e mbulimit të importeve nga eksportet	%	26.5	25.4	26.2
Shkalla e hapjes ekonomike	%	38.6	38.8	43.4


Burimi: Banka e Shqipërisë.

Tabelë 2. Tregtia e mallrave.

Importet vazhdojnë të përbëjnë kahun kryesor të rrjedhjes së shkëmbimeve tregtare të Shqipërisë me botën, duke përfaqësuar mëse 79 për qind të vëllimit tregtar.

Ndonëse, rritja premtuese e eksporteve gjatë këtij viti (prej 19 për qind), ka tejkalluar rritjen e importeve (prej 15 për qind), baza e ulët e tyre nuk ka mundur të zbusë deficitin tregtar, i cili vazhdon të thellohet duke kapur nivelin 1.8 miliardë euro ose 14 për qind më i lartë se ai i vitit paraardhës.

Në terma nominalë, importet e mallrave u rritën me 324 milionë euro duke kapur shifrën vjetore prej 2.4 miliardë eurosh, ndërkohë që eksporti i mallrave ka realizuar 630 milionë euro të ardhura. Nivele të ulta të kontributit të eksporteve në PBB regjistrohën edhe këtë vit, 9 për qind, por vlen për t'u përmendur përmirësimi i këtij indeksi, krahasuar me vitin 2005.



- Eksporti i mallrave

Ekziston një shpërndarje jopërpjestimore e eksporteve tona sipas dy sektorëve prodhues. Sektori industrial, me një nivel përfaqësimi prej 92 për qind në totalin e eksporteve, u vlerësua 19 për qind më i lartë se ai i vitit paraardhës. Vlen për t'u përmendur edhe rritja e konsiderueshme e mallrave bujqësorë, me 15 për qind, të përqendruara kryesisht në ushqime të përgatitura të mishit dhe peshkut, dhe farat vajore.

Ndërkohë, zhvillime pozitive ka shfaqur eksporti i brendshëm (eksporte në bakër, në minerale dhe në lëndë djegëse minerale), duke kontribuar ndjeshëm në rritje të të ardhurave të eksportit për vitin 2006.

Eksporti i bakrit dhe i artikujve të tij u trefishua, me treg të përqendruar kryesisht drejt Italisë. Kontributi i tij në rritjen vjetore të eksportit, vlerësohet në rreth 15 për qind.

Eksporti në produkte minerale është rritur me rreth 72 për qind dhe kontribuoi me rreth 20 për qind në rritjen e të ardhurave totale të eksportit të mallrave.

Eksporti i mineralit të kromit dhe hekurit dha ndikimin kryesor në rritjen e vëllimit të eksportit të mineraleve gjatë këtij viti. Eksporti i kromit u rrit rreth 4 herë si në terma nominalë ashtu edhe në sasi, dhe pati për destinacion Kinën. Ndërkohë, eksporti i hekurit u dyfishua, me tregje drejt vendeve të rajonit (kryesisht në Maqedoni). Rritja e çmimeve në tregjet ndërkombëtare për këta mallra mendohet të ketë ndikuar ndjeshëm në ecurinë e eksportit të tyre.

Eksporti i lëndëve djegëse, gjithashtu, u dyfishua. Nafta e papërpunuar, përfaqëson rreth 70 për qind të eksportit të kësaj kategorie. Destinacioni kryesor ishte Italia. Efekti i këtyre eksporteve në totalin e të ardhurave nga eksporti për vitin 2006 vlerësohet të jetë 12 për qind, efekt ky i përforcuar edhe nga rritja e çmimit të naftës.

Tabelë 3. Eksporti sipas klasifikimit SITC.

KODI	PËRSHKRIMI	2004	2005	2006	2004	2005	2006	2006/2005
		Vlera në milionë euro			Struktura në %			Ndryshimi në %
0	Ushqime dhe kafshë të gjalla	19.9	20.4	26.8	4.1	3.9	4.2	31.1
1	Pije dhe duhan	7.6	9.6	8.3	1.6	1.8	1.3	(13.5)
2	Materiale të papërpunuara	18.5	25.6	34.9	3.8	4.8	5.5	36.0
3	Lëndë djegëse	13.2	15.4	27.3	2.7	2.9	4.3	77.6
4	Yndyrna bimore dhe shtazore	0.3	0.2	0.5	0.1	0.0	0.1	88.4
5	Produkte kimike	2.8	4.8	6.2	0.6	0.9	1.0	30.1
6	Mallra të përpunuar	97.3	114.3	141.5	20.0	21.6	22.4	23.8
7	Makineri dhe pajisje	19.1	22.1	24.5	3.9	4.2	3.9	10.7
8	Mallra të tjerë të përpunuar	307.0	317.7	360.8	63.2	59.9	57.2	13.6
9	Mallra të paklasifikuar diku tjetër	-	-	-	-	-	-	
	TOTALI	485.6	530.2	630.7	100.0	100.0	100.0	19.0

Burimi: Banka e Shqipërisë.

- Importi i mallrave

Rritja e pazakontë e çmimeve të naftës, importet e larta në energji elektrike si dhe rritja e çmimeve të metaleve në tregjet botërore, e shoqëruar kjo me kërkesën e lartë për mallra konsumi, përbëjnë faktorët kryesorë në rritjen e importeve gjatë vitit 2006.

Plotësimi i nevojave të brendshme me energji elektrike, si dhe rritja e çmimit të energjisë - duke pasuar zhvillimet në çmimin e naftës - (shih- Box 2), kanë pesëfishuar shpenzimet në importe të kësaj kategorie. Ndërkohë që, sasia e importuar u rrit gjithashtu ndjeshëm, me rreth 3.5 herë krahasuar me një vit më parë. Po kështu, importi i karburanteve rezultoi 22 për qind më i lartë se në vitin 2005. Kontributi i energjisë elektrike dhe ai i karburanteve në rritjen totale të importit, vlerësohen respektivisht 8 për qind dhe 12 për qind.

Tabelë 4. Importi sipas klasifikimit SITC.

KODI	PËRSHKRIMI	2004	2005	2006	2004	2005	2006	2006/2005
		Vlera në milionë euro			Struktura në %			Ndryshimi në %
0	Ushqime dhe kafshë të gjalla	266.08	272.33	320.9	14.5	13.1	13.3	17.8
1	Pije dhe duhan	61.51	64.71	77.3	3.4	3.1	3.2	19.5
2	Materiale të papërpunuara	58.82	75.91	86.1	3.2	3.6	3.6	13.4
3	Lëndë djegëse	141.10	181.77	254.9	7.7	8.7	10.6	40.2
4	Yndyrna bimore dhe shtazore	26.52	28.50	31.5	1.4	1.4	1.3	10.7
5	Produkte kimike	166.62	201.75	252.5	9.1	9.7	10.5	25.2
6	Mallra të përpunuar	427.48	509.85	618.2	23.4	24.5	25.6	21.3
7	Makineri dhe pajisje	431.49	488.97	484.7	23.6	23.5	20.1	(0.9)
8	Mallra të tjerë të përpunuar	250.90	260.07	284.7	13.7	12.5	11.8	9.5
9	Mallra të paklasifikuara diku tjetër	-	-	-	-	-	-	
	TOTALI	1,830.51	2,083.85	2,410.9	100.0	100.0	100.0	15.7

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Kërkesa e lartë e këtyre viteve të fundit për mallra farmaceutikë, ndikuar edhe nga zhvillimet botërore në këtë kategori<sup>3</sup>, ka sjellë rritje të konsiderueshme të kategorisë "mallra kimike", prej 25 për qind krahasuar me një vit më parë.

Vërehet një tendencë rritëse kundrejt importeve të mallrave bujqësorë, të cilët gjatë vitit 2006 përshejtuan ritmet e rritjes krahasuar me një vit më parë, duke qenë 18 për qind më të larta. Ato tejkaluan kështu edhe ritmin e rritjes të sektorit industrial prej 15 për qind. Impaktin më të madh e dhanë drithërat, pijet dhe alkolet.

Kërkesat gjithnjë e më të larta të sektorit të ndërtimit kombinuar dhe me rritjen e çmimeve, çuan në rritjen me 30 për qind të importeve të metaleve. Ndërkohë, makineritë dhe pajisjet, të cilat zënë dhe peshën më të rëndësishme, rreth 14 për qind të importeve, këtë vit pësuan një rënie të lehtë (me 1 për qind), duke thyer kurbën rritëse që ka karakterizuar këtë grupmall, gjatë viteve të fundit. Megjithatë, importi i tyre këtë vit mbetet rreth 30 për qind më i lartë krahasuar me mesataren e importeve në makineri dhe pajisje, përgjatë viteve 2000-2005.


**Boks 1. Karburantet - zhvillime botërore dhe ndikime në tregtinë e jashtme.**

*Ekonomia botërore nga viti në vit gjendet përballë fenomenit të shumëpërfolur për burimet natyrore të karburanteve dhe manipulimin me çmimet e tyre. Trazirat në Lindjen e Mesme si lufta në Irak, programi nuklear në Iran si dhe mungesa e stabilitetit në Arabinë Saudite, bënë që rajoni më i madh i prodhimit të karburanteve, të zvogëlojë eksportin e tyre. Pothuajse të gjitha këto vende pësuan rënie në prodhimin e ri të karburanteve, ndërkohë që vetëm Evropa Lindore dhe vendet e ish-BS patën një rritje prej 4.3 për qind. Çmimi i shitjes së naftës arriti pikun e tij për vitin 2006, në korrik kur çmimi i shitjes së një fuçje naftë arriti në 78 usd, ndërkohë që çmimi mesatar për vitin u vlerësua të ishte 67 usd, afërsisht 10 usd ky, më i lartë se ai i vitit 2005.*

*Një nga prirjet më interesante gjatë këtij viti, ishte rritja e konsiderueshme e konsumit në vendet eksportuese të karburanteve. Kjo është një prirje që mbetet për t'u vëzhguar, për sa kohë në një zonë me rritje të ngadaltë, rritja e shpejtë e kërkesës nga eksportuesit, do të thotë më pak karburante të gatshme për t'u eksportuar.*

*Zëri karburante dhe lubrifikante pësoi një rritje të ndjeshme prej 40 për qind në krahasim me vitin paraardhës, duke përfaqësuar kështu 11 për qind të totalit të shpenzimeve për import të vendit tonë. Në terma vëllimi, karburantet u rritën me 10 për qind, ndërkohë që në milionë euro rritja qe më e ndjeshme, 28 për qind, duke reflektuar kështu edhe rritjen e çmimeve.*

Grafik 1, boks 1. Ecuria e lëndëve djegëse në vite.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

*Kushtet jo të përshtatshme atmosferike që karakterizuan Evropën gjatë stinës së ftohtë të vitit 2006 si dhe kriza energjitiqe, e shkaktuar nga ndërprerja e furnizimeve me gaz nga Rusia, kushtëzuan nivele të larta të çmimit të energjisë elektrike. Kështu, evropianët zbuluan që konsumi i tyre i energjisë elektrike, ishte në varësi të Qeverisë Ruse dhe të importit.*

*Vendi ynë, gjatë këtij viti shpenzoi 31 milionë euro për importin e energjisë elektrike. Vlen për t'u përmendur këtu dhe efekti i dyfishtë që pati forcimi i monedhës evropiane kundrejt dollarit amerikan, duke i bërë eksportet më të kushtueshme, por në të njëjtën kohë duke lehtësuar faturat importuese të energjisë.*

*Çmimet e larta të karburanteve dhe energjisë sjellin rritjen e kostos së prodhimit të mallrave, duke dhënë kështu impakt të drejtpërdrejtë në nivelin e çmimeve dhe në inflacion.*

## Boks 2. Përpilimi dhe analiza e importeve sipas BEC.


Për analiza më të agreguara të tregtisë së jashtme, na vjen në ndihmë klasifikimi sipas kategorive të gjera ekonomike (BEC), që tashmë aplikohet në të dhënat e tregtisë së jashtme që prej vitit 2003.

BEC klasifikon produktet duke u bazuar në Klasifikimin Standard të Tregtisë së Jashtme (SITC), së pari sipas natyrës së tyre (të dorës së parë ose të dorës së dytë) dhe së dyti, sipas qëllimit përfundimtar të përdorimit. Nëpërmjet këtij klasifikimi ne arrijmë të masim rëndësinë e ndarjes së proceseve të prodhimit. Ky lloj klasifikimi dallon 19 kategori bazë, të cilat në harmoni me statistikën kombëtare përbliken në 3 grupe të mëdha: mallra kapitalë, mallra të ndërmjetëm dhe mallra konsumi.

Transaksionet e tregtisë së jashtme tregojnë për një përqendrim të theksuar drejt mallrave të ndërmjetëm, të cilët gjatë viti 2006 përfaqësuan pjesën dërrmuese të importeve (51 për qind). Ndërkohë, vendi ynë mbetet importues në vëllime të mëdha të mallrave të konsumit (37 për qind), të cilët janë rritur ndjeshëm në dëm të mallrave kapitalë.

Kategoria e mallrave të ndërmjetëm, duke përfshirë një gamë të gjerë artikujsh, dha efektin më të madh në rritjen e importit total vjetor, duke ndikuar me 60 për qind. Ky zgjerim i mëtejshëm ishte rezultat i kërkesës së lartë për materiale industriale të përpunuara. Ato përfaqësuan 66 për qind të kësaj kategorie, ku veçojmë plastikën dhe artikujt prej saj. Në një shpërndarje të mëtejshme të mallrave të ndërmjetëm, peshën më të madhe e zënë mallrat gjysmë të përfunduar (81 për qind), ndërsa mallrat primarë, pjesët dhe aksesoret përfaqësuan respektivisht 9 për qind dhe 10 për qind të kësaj kategorie. Klasifikimi i karburanteve dhe lubrifikanteve të përpunuar si mallra të ndërmjetëm dhe konsumi, ka dhënë impakt të ndjeshëm në zgjerimin e këtyre kategorive, duke reflektuar kështu vëllimet e mëdha të energjisë elektrike të importuar gjatë këtij viti si dhe rritjen e përgjithshme të çmimeve të këtyre mallrave<sup>4</sup>. Ndërkohë, kërkesa e lartë për konsum të kategorisë pije dhe ushqime, u reflektua në nivele të larta përfaqësimi në mallrat e konsumit (31 për qind).

Grafik 1, boks 2. Kontributi në ndryshimin e totalit të importeve.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

	2004	2005	2006	2006/2005
				Ndryshimi në %
Mallrat kapitalë	14.8	14.7	12.3	(3.6)
Mallrat e ndërmjetëm	47.8	48.9	50.5	19.4
Mallrat e konsumit	37.4	36.4	37.3	18.5


Mallrat kapitalë, të cilët gjatë viteve të fundit kanë njohur prirje të ndjeshme rritëse, duke reflektuar kërkesë të lartë për investime në vend, këtë vit kanë njohur një rënie prej 3.6 për qind.

Një paraqitje më të detajuar të statistikave të importit tregtar sipas klasifikimit BEC, do ta gjeni në aneksin bashkëngjitur (Tabela – BEC).

- Tregtia nga industria e përpunimit aktiv

Tkurria e industrisë përpunuese në vend, e vërejtur gjatë vitit të kaluar - pasojë e rritjes së presioneve konkurrionale në industrinë - kyçe të eksporteve shqiptare (tekstile dhe këpucë), e hapjes së tregjeve evropiane drejt vendeve të Lindjes së Largët (Kina, India) dhe Turqisë, shoqëruar kjo edhe me ngadalësimin e rritjes ekonomike në vendet partnere, si dhe me situatën e përkeqësuar në furnizim me energji elektrike në vend - është recuperuar ndjeshëm gjatë këtij viti.

Me një vëllim të përgjithshëm prej 791 milionë eurosh, tregtia nga industria e përpunimit aktiv ruajti të njëjtat nivele përfaqësimi të një viti më parë, rreth 26 për qind të transaksioneve tregtare të kryera gjatë vitit 2006.



Rieksporetet përfaqësuan 71 për qind të totalit të eksporteve, ndërkohë 14 për qind e importeve ishte lëndë e parë për përpunim të mëtejshëm.

Masat antidumping të marra nga Bashkimi Evropian<sup>5</sup>, ndikuan ndjeshëm në përmirësimin e situatës së industrisë përpunuese në vend (tekstile dhe këpucë). Pikërisht suficiti tregtar që erdhi nga kjo industri, gjatë këtij viti, rezultoi 45 për qind më i lartë se ai i një viti më parë. Industria e tekstileve dhe këpucëve përbën thelbin e industrisë eksportuese në vend, duke kontribuar me rreth 55 për qind në të ardhurat vjetore nga eksporti i mallrave.

Tregjet dominuese në aktivitetin e kësaj industrie mbeten partnerët fqinjë, Italia dhe Greqia, të cilat prej vitesh janë pozicionuar bindshëm në tregun shqiptar.

- Tregtia sipas partnerëve tregtarë

BE mbetet dominuese në shkëmbimet tregtare të vendit tonë me botën, duke përfaqësuar 64 për qind të totalit të tyre. Shkalla e ulët e diversifikimit të shpërndarjes gjeografike të tregtisë, tregon për një varësi të theksuar kundrejt fqinjëve Itali dhe Greqi, duke tërhequr kështu vëmendjen drejt eksplorimit të tregjeve të reja.

Viti 2006 shënoi edhe nënshkrimin e dy marrëveshjeve tepër të rëndësishme për vendin tonë, asaj me BE-në dhe me Turqinë (shih aneksin 1). Gjatë këtyre viteve të fundit, Turqia është shndërruar në një nga partneret kryesore tregtare të Shqipërisë, me një vëllim transaksionesh prej 190 milionë eurosh, gjë që shton vëmendjen drejt MTL-së me këtë shtet. Edhe kurorëzimi i negociatave për nënshkrimin e MSA, pritet të sjellë efekte të ndjeshme kundrejt hapjes së tregjeve me këto vende. Këto marrëveshje, kanë hyrë në fuqi respektivisht në 1 dhjetor të vitit 2006 dhe 1 janar 2007.



Eksporti	Pesha në eksporte			Ndryshimi vjetor %
	2004	2005	2006	
Total	100.0	100.0	100.0	19.0
Vendet e BE-15	89.9	88.0	87.7	18.6
Itali	73.0	72.4	72.6	19.3
Greqi	12.0	10.5	9.6	9.4
Gjermani	3.1	3.3	3.2	13.1
Vendet e Evropës Juglindore	8.5	9.2	9.3	19.8
Ish-Jugosllavi	0.4	0.8	1.4	91.0
Maqedoni	1.2	1.6	1.6	20.9
Kosovë	4.5	4.1	3.8	8.6
Vende të tjera	1.6	2.7	2.9	28.5

Burimi : Banka e Shqipërisë.

Tabelë 5. Shpërndarja e eksporteve sipas partnerëve tregtarë në vite.

Ritmet e rritjes së eksporteve drejt vendeve të BE-së dhe atyre të rajonit, duket se kanë ecur krah për krah gjatë këtij viti, duke qenë përkatësisht 18.6 për qind dhe 19.8 për qind. E kundërt paraqitet situata në kahun e importeve, ku ka pasur fluks të madh nga vendet e rajonit, me një rrije prej 32 për qind. Duket se furnizimi me lëndë djegëse dhe energji elektrike gjatë këtij viti, ka ardhur nga Ballkani dhe pikërisht nga Rumania, e cila si rezultat regjistroi rritjen më të ndjeshme në importe (rreth 170 për qind). Ritme të larta të zgjerimit të importeve kanë pësuar edhe partnerët e tjerë të rajonit, çka dëshmon për një përfitim më të mirë nga Marrëveshjet e Tregtisë së Lirë nga ana e tyre, kundrejt vendit tonë.

Rivendosja e kuotave për eksportin e tekstileve, në qershor të vitit 2005 nga OBT, solli zbutjen e ndikimit të konkurrencës kineze në këtë industri. Kjo u ndje edhe gjatë vitit 2006, kur importet nga ky vend pësuan një rritje modeste, prej 4 për qind.

Importi	Pesha në importe			Ndryshimi vjetor %
	2004	2005	2006	
Total	100.0	100.0	100.0	15.7
Vendet e BE-15	65.0	60.4	57.5	10.1
Itali	32.6	29.3	28.1	10.9
Greqi	18.6	16.6	15.8	10.0
Gjermani	6.2	5.4	5.6	20.7
Vendet e Evropës Juglindore	12.8	14.8	16.9	32.1
Bullgari	2.0	2.8	2.7	12.0
Bosnje-Hercegovinë	0.0	0.1	0.3	142.8
Kroaci	1.3	1.2	1.4	38.5
Serbi dhe Mal i Zi	0.6	0.6	0.9	64.0
Maqedoni	1.0	1.2	1.6	50.4
Rumani	0.4	0.7	1.7	173.5
Turqi	7.1	7.5	7.6	17.4
Rusi	2.8	4.1	4.1	16.1
Ukrainë	2.5	2.9	3.9	54.5
Vende të tjera	22.0	25.0	25.6	19.5

Burimi : Banka e Shqipërisë.

Tabelë 6. Shpërndarja e importeve sipas partnerëve tregtarë në vite.


### 1.2.2 SHËRBIMET

Marrëdhëniet tregtare në fushën e shërbimeve, janë shndërruar në një fenomen gjithnjë e më të pranishëm në shkëmbimet tregtare të Shqipërisë me botën, duke ndihmuar në zhvillimin dhe integrimin global të vendit.

Tregtia në shërbime, përgjatë viteve 2000 është rritur me një mesatare vjetore prej rreth 17 për qind dhe është zhvilluar më shpejt se ajo në mallra, vëllimi tregtar i të cilëve vlerësohet mesatarisht në rreth 13 për qind.


Në totalin e përgjithshëm tregtar (mallra dhe shërbime), shërbimet kanë siguruar mëse 64 për qind të të ardhurave në valutë të vendit, ndërsa importi i shërbimeve ka përbërë rreth 31 për qind të importeve totale, mesatarisht përgjatë viteve 2000.

Grafik 5. Bilanci i shërbimeve - fluksi neto në milionë euro.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 6. Rritja vjetore në importe dhe eksporte shërbimesh.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Për vitin 2006, shkëmbimet tregtare në shërbime vlerësohen në rreth 2.5 miliardë euro, me një rritje vjetore prej 18.4 për qind, kundrejt vitit të kaluar. Ky vëllim vlerësohet të jetë rritur me 3 pikë përqindjeje ndaj një viti më parë, duke arritur në 34 për qind ndaj PBB-së.

Pozicioni neto i kësaj kategorie, përgjatë viteve të fundit është luhatur rreth vlerave negative (grafik 7.). Për vitin 2006, eksporti neto i shërbimeve u vlerësua 67 milionë euro, me një përmirësim të dukshëm krahasuar me vitin paraardhës. Këtë vit, të ardhurat nga eksporti në shërbime u rritën më shpejt se shpenzimet për importe shërbimesh (grafik 8.).

Ndërgjegjësimi i aktorëve të ekonomisë tonë për të rritur cilësinë dhe për të zgjeruar gamën e shërbimeve që ata ofrojnë për jorezidentët, duhet vlerësuar pozitivisht. Përmirësimi i pozicionit neto të shërbimeve, këtë vit i dedikohet rritjes së konsiderueshme të të ardhurave në kategorinë "shërbime të tjera", që ka sjellë tkurrjen në masë të konsiderueshme të deficitit në këtë kategori duke amortizuar, gjithashtu, ngushtimin e suficitit në kategorinë "udhëtime".

Zhvillimet në sektorin e shërbimeve, gjatë viteve të fundit, janë karakterizuar nga liberalizimi i tregut, zgjerimi i teknologjisë në shërbimet e informacionit, shumëllojshmëria e shërbimeve kulturore, si dhe rritja në vëllimin e shërbimeve financiare. Megjithatë, shërbimet e përfituara dhe të ofruara në kategorinë "udhëtime", vazhdojnë të kenë kontributin kryesor në këtë sektor për Shqipërinë (tabelë 7.).

	Pesha në eksporte (%)		Pesha në importe (%)	
	2005	2006	2005	2006
Total	100.0	100.0	100.0	100.0
1.Shërbime transporti	10.6	10.9	16.6	15.8
2.Shërbime sigurimi	0.5	0.2	2.2	2.3
3.Shërbime udhëtimi	71.5	67.3	57.4	60.9
4.Shërbime të tjera	17.5	21.6	23.8	21.1
i. Shërbime komunikacioni	6.0	3.5	1.1	0.5
ii.Shërbime konstruksioni	0.2	0.2	0.1	0.1
iii.Shërbime kompjuteri dhe informacioni	0.3	0.1	0.2	0.2
iv.Asistencë teknike	0.0	0.0	3.7	1.3
v. Shërbime qeveritare	0.9	1.5	1.1	0.8
vi.Shërbime financiare	1.3	1.7	1.3	1.3
vii.Shërbime personale, kulturore e biznesi	1.3	1.7	8.1	5.6
viii.Shërbime të tjera	7.5	12.9	8.2	11.4

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Tabelë 7. Struktura e importit dhe eksportit të shërbimeve.


- Shërbime udhëtimi

Turizmi në Shqipëri, aktualisht përfaqëson aktivitetin me prurjet më të larta në valutë për ekonominë shqiptare. Sipas vlerësimeve të Bankës së Shqipërisë, eksporti në turizëm, gjatë vitit 2006 ka gjeneruar rreth 804 milionë euro flukse të ardhurash, një vlerë kjo rreth 28 për qind më e lartë se vlera e eksporteve të mallrave.

Bilanci pozitiv i kësaj llogarie ka ardhur duke u ngushtuar në 37 milionë euro nga 56 milionë i vlerësuar një vit më parë, si rezultat i rritjes më të shpejtë të importit (21 për qind) ndaj eksportit (16 për qind). Këto të ardhura neto kanë mundur të financojnë deri në masën 2 për qind deficitin tregtar, për vitin 2006.


Rritja vjetore e të ardhurave nga turizmi vlerësohet në rreth 16 për qind. Kjo rritje është influencuar, kryesisht nga rritja e numrit të shtetasve të huaj dhe e emigrantëve që kanë vizituar vendin (rreth 21 për qind më e lartë ndaj vitit 2005), krahas rritjes së lehtë të shpenzimeve ditore dhe ditëqëndrimit të tyre në Shqipëri. Rreth 90 për qind e fluksit hyrës vjen nga vendet e Bashkimit Evropian, kryesisht të përfaqësuar nga emigrantët shqiptarë që janë rezidentë në këto vende. Pjesa tjetër i përket vendeve të rajonit. Të ardhurat nga turizmi rrisin indirekt kërkesën për faktorët e prodhimit (toka, puna, kapitali) rrjedhimisht edhe kontributin në të ardhurat kombëtare, duke e shndërruar turizmin në një aktivitet me produktivitet të lartë. Sipas treguesit të shitjeve për vitin 2006, sektori i hotelarisë dhe restoranteve, me një rritje vjetore prej 27 për qind vlerësohet si një ndër sektorët me ritëm rritjeje të lartë, veçanërisht gjatë tremujorit të dytë dhe atij të tretë të vitit. Historiku i fluksit të valutës së hyrë në Shqipëri, siç vërehet dhe në grafikun në vijim, tregon për epërsi të eksportit të shërbimeve të udhëtimit ndaj eksportit të mallrave dhe një prirje të njëjtë edhe në të ardhmen.

Grafik 7. Ecuria e eksportit të mallrave dhe e rritjes relative të eksportit udhëtime/mallra.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 8. Shpenzimet për turizëm ndaj fluksit hyrës të remitancave.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Njëkohësisht kërkesa për mallra e shërbime të udhëtarëve shqiptarë rezidentë në vendet e Bashkimit Evropian të përfaqësuar nga Greqia, Italia, vendet e rajonit si Kosova, Mali i Zi, Maqedonia çoi në regjistrimin e një importi shërbimesh turizmi prej rreth 768 milionë eurosh. Këto shpenzime zënë rreth 82 për qind të prurjeve të emigrantëve dhe vlerësohen me një rritje vjetore rreth 21 për qind (grafik 4). Në këtë rritje, ka ndikuar rritja prej 22.4 për qind e numrit të udhëtarëve, ndërsa koeficientët vlerësues për ditëqëndrimin dhe shpenzimet mesatare ditore kanë ruajtur nivelet e një viti më parë.

Turizmi, gjithnjë e më shumë po shihet si një burim mbështetës për llogarinë korente. Përmirësimi i shërbimeve turistike brenda vendit duke i bërë ato më tërheqëse, përmirësimi veçanërisht i infrastrukturës përkatëse do të vepronte njëherësh

si në rritjen e të ardhurave ashtu edhe në pakësimin e shpenzimeve të këtij sektori. Megjithë konkurrencën e fortë nga vendet e rajonit (Greqia, Mali i Zi, Kroacia) dhe mungesën e subvencionimeve, sektori i turizmit ka potencialin të kontribuojë pozitivisht në rritjen ekonomike. Ndërmarrja e politikave zhvilluese në këtë sektor, përveç marketingut ndërkombëtar, duhet të synojë së pari në përmirësimin e infrastrukturës, ndërtimi dhe modernizimi i të cilës është një kërkesë jo vetëm e këtij sektori, por e të gjithë ekonomisë.

- Shërbime transporti dhe sigurimi

Shërbimet e transportit ndjekin ecurinë e tregtisë së mallrave dhe të shërbimeve të udhëtimit. Gjatë vitit 2006, këto shërbime regjistruan një deficit prej 69 milionë eurosh, më të ulët se një vit më parë, si rezultat i rritjes vjetore më të madhe në eksporte (27 për qind) se sa në importe (8 për qind). Liberalizimi në fushën e transporteve, duke sjellë kompani të reja transporti, ajrore, rrugore dhe detare do të rrisë më tej cilësinë e për rrjedhojë, edhe vëllimin e këtyre shërbimeve.

Shqipëria vazhdon të jetë importuese neto e shërbimeve të sigurimit, me një vlerë prej 26 milionë eurosh. Thellimi i deficitit negativ në këto shërbime ka ardhur si rezultat i rënies në eksporte me 60 për qind dhe i rritjes prej 15 për qind në importe, kundrejt një viti më parë. Për më shumë se një dekadë, ky treg është karakterizuar nga procesi i privatizimit, rritja e numrit të kompanive operuese, që kanë çuar në rritjen e interesit të investitorëve të huaj për blerjen e disave prej tyre. Zhvillimet e mësipërme vlerësohen pozitive, veçanërisht në rritjen e eksporteve të këtyre shërbimeve, gjë që do të përmirësojë deficitin në këto shërbime.

- Shërbime të tjera

Kategoria "shërbime të tjera" në fund të vitit u mbyll me një deficit prej 9 milionë eurosh, kundrejt 95 milionë eurove të një viti më parë. Kjo kategori

shërbimesh po zhvillohet me ritme të shpejta, veçanërisht përsa i përket krahut të eksporteve. Të ardhurat e përftuara nga eksporti i këtyre shërbimeve, kanë njohur rritje vjetore prej 50 për qind dhe tërheqin vëmendjen për përshpejtimin e këtij aktiviteti në vend. Zhvillimet ekonomike brenda kësaj kategorie, karakterizohen nga liberalizimi i tregut në shërbimet e komunikacionit, zgjerimi i teknologjisë në shërbimet e informacionit, shumëllojshmëria e shërbimeve kulturore si dhe rritja në vëllimin e shërbimeve qeveritare dhe të atyre financiare.


### 1.2.3 TË ARDHURAT

Bilanci pozitiv i të ardhurave faktoriale në fund të vitit (208.6 milionë euro) vlerësohet i rritur ndjeshëm kundrejt vitit paraardhës (53.2 për qind). Këtë vit, rritja nuk i dedikohet vetëm bilancit të të ardhurave nga puna e punonjësve sezonalë por edhe nga të ardhurat neto, në formën e interesave apo të dividendëve të akumuluar nga investimet e portofolit dhe rezervave valutore të sistemit bankar, në institucionet financiare jorezidente.

Të ardhurat hyrëse nga puna e punonjësve sezonalë, këtë vit (145 milionë dollarë) regjistruan një rritje vjetore prej 46.1 për qind. Të ardhurat nga investimet tona jashtë, këtë vit, paraqiten me një rritje prej 49 për qind dhe kryesisht kanë ardhur si rrjedhojë e investimeve të sistemit bankar, në formën e investimeve të portofolit, me një rritje vjetore prej 36 për qind. Vlen të përmenden këtu edhe të ardhurat në formën e interesave, të përftuara nga rezervat e mjeteve valutore të sistemit tonë bankar jashtë si dhe dividendëve nga investimet tona direkte në ekonominë e huaja, kryesisht të sektorit financiar.

Ndërkohë, të ardhurat dalëse regjistrojnë rreth 54.4 milionë euro. Këto përfaqësohen nga shërbimet e borxhit të jashtëm në formën e interesave të maturuar si dhe nga interesat apo dividendët e përftuar prej njërive jorezidente, nga investimet e huaja në ekonominë shqiptare.


Shqipëria gjatë vitit 2006 ka paguar 24 milionë euro për të shlyer interesat mbi borxhin e saj të jashtëm, të cilët vlerësohen lehtësisht në rënie kundrejt vitit 2005 (4 për qind).



### 1.2.4 TRANSFERTAT KORENTE

Të ardhurat nga emigrantët me një rëndësi jetësore për pjesën më të madhe të shqiptarëve, janë bërë një nga femomenet tipike, më të përfolura në ekonominë shqiptare. Vitet e fundit, këto para nuk konsiderohen vetëm si burime të ardhurash për qëllime joproduktive, për përmbushjen e nevojave themelore aktuale që

Grafik 10. Ecuria e dërgesave të emigrantëve (në milionë euro).



Burimi: Banka e Shqipërisë.

lidhen me përmirësimin e kushteve të jetesës, por kanë qenë burime financimi për qëllime produktive, në formën e investimeve në pasuri të patundshme apo të investimeve të tjera afatgjata.

Totali i dërgesave nga emigrantët, për vitin 2006 vlerësohet të jetë rreth 935 milionë euro ose 13 për qind e PBB-së. Këtë vit, këto dërgesa regjistrojnë një rritje prej 4.6 për qind me një prirje në rënie kundrejt viteve të kaluara. Kështu, kontributi i këtyre dërgesave në zbutjen e deficitit tregtar llogaritet në rreth 55.5 për qind, i cili vlerësohet të jetë 5 pikë përqindje më pak se në vitin e kaluar.

Prurjet nga emigrantët, janë shoqëruar edhe nga transfertat zyrtare prej rreth 50 milionë eurosh, 77 për qind e të cilave janë në formë të asistencës teknike.


### 1.3 LLOGARIA KAPITALE DHE FINANCIARE

Viti 2006 karakterizohet nga një lëvizje shumë e madhe e kapitalit në të dyja kahet, si në flukset hyrëse ashtu edhe në ato dalëse. Përveç rritjes së transfertave të njëanshme, këtë vit vërehen flukes të larta të kapitalit. Megjithatë, viti u mbyll me një bilanc pozitiv të llogarisë kapitale dhe financiare (rreth 552.3 milionë euro), duke mundur plotësisht financimin e deficitit korent. Transfertat kapitale, të cilat karakterizohen kryesisht nga grante me karakter investimi si në sektorin shtetëror ashtu edhe në atë privat vlerësohen 143 milionë ose 44.6 për qind më të larta se ato të vitit të kaluar.

Në llogarinë financiare vihet re një rritje sinjifikative e mjeteve tona valutore të investuara jashtë ekonomisë shqiptare, kryesisht atyre të sistemit

bankar, përfaqësuar nga investime afatshkurtra dhe afatmesme. Akumulimi i madh, i ndodhur këtë vit, i mjeteve valutore në sistemin bankar ka detyruar këtë të fundit që të zgjedhë alternativën e rritjes së investimit të tij në institucionet financiare jashtë. Gjithashtu, vihet re një ndryshim i raportit të mjeteve të investimeve të këtyre institucioneve financiare, duke zhvendosur investimet e portofolit në mjete valutore, në formën e depozitave në bankat e huaja.

Grafik 11. Llogaria financiare në vite – fluksi neto në milionë euro.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

#### 1.3.1 NATYRA DHE PËRBËRJA E FLUKSEVE TË KAPITALIT

Flukset në llogarinë financiare ndahen midis të tre kategorive kryesore – investime direkte, investime portofoli dhe investime të tjera.

- Investimet direkte

Fluksi i investimeve të huaja direkte gjatë vitit 2006, regjistroi 260 milionë euro kundrejt 224 milionë eurove realizuar në vitin e kaluar. Ato vijojnë të jenë një faktor dominues në rritjen e detyrimeve financiare dhe në zhvillimet e transaksioneve kapitale e financiare të vendit. Investitorët nga vendet e Bashkimit Evropian (Itali, Greqi), të cilët janë edhe partnerë të tregtisë, vazhdojnë të dominojnë këto investime, që përqendrohen kryesisht në industrinë përpunuese të tekstileve (veshjeve dhe të këpucëve).

Marrëveshjet e tregtisë së lirë me BE pritet të ndikojnë pozitivisht në rritjen e fluksit të investimeve direkte nga vendet evropiane.

Zhvillimet e vullshme në sektorin e ndërtimit gjatë viteve të fundit, duket se po tërheqin vëmendjen e investitorëve të huaj. Prania e kapitalit të huaj në këtë sektor është rritur ndjeshëm përgjatë dy viteve të fundit, duke sjellë me vete flukse të reja të kapitalit të huaj në fusha të reja mbështetëse të këtij sektori, si aktivitete arkitekturore dhe inxhinierike. Gjithashtu, vihen re rritje të kapitalit të huaj në sistemin financiar si dhe në fushën e telekomunikacionit.

- Investimet e portofolit


Investimet e portofolit në bilancin shqiptar të pagesave janë prezantuar në formën e mjeteve tona financiare, kryesisht të sistemit tonë bankar në bono thesari të emetuara nga qeveri të huaja. Në fund të vitit 2006, stoku i investimeve të portofolit të ekonomisë shqiptare jashtë, u vlerësua 84 milionë euro me një fluks në rënie prej 27.2 milionë eurosh. Kjo rënie ka ardhur si rezultat i zhvendosjes së mjeteve të sistemit bankar në investime në formën e depozitave afatshkurtra dhe afatmesme, me institucionet financiare jashtë. Në përbërjen strukturore sipas monedhave 77 për qind i përkasin atyre në dollarë, 16 për qind në euro dhe 7 për qind në stërlinën angleze.

- Investime të tjera

*Detyrimet financiare* në formën e depozitave të institucioneve jorezidente në sistemin tonë bankar, janë ulur me rreth 124 milionë euro. Në përbërjen e depozitave sipas monedhës, peshën më të madhe e zënë ato në monedhën evropiane euro me 61 për qind, ndjekur nga dollari amerikan me 32 për qind dhe franga zviceriane me 6 për qind.

Detyrimet e ekonomisë shqiptare në formën e kredisë tregtare u rritën me rreth 8 milionë euro, e reflektuar kjo edhe në rritje të importeve për këtë periudhë. Megjithatë, këtë vit është lëvruar rreth 13 për qind më shumë kredi tregtare se një vit më parë.

Grafik 12. Financimi i deficitit korent nëpërmjet investimeve të huaja direkte.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Rritje e konsiderueshme prej 67 milionë eurosh, u vu re në detyrimet e tjera valutore në formën e huave afatshkurtra dhe afatmesme marrë nga njësitë jorezidente.

Flukset hyrëse të investimeve të huaja direkte dhe të atyre në formën depozitave janë shoqëruar me flukse të kapitalit në formën e huamarrjes, duke rritur borxhin e jashtëm të Shqipërisë nëpërmjet lëvimeve të kredive afatgjata dhe atyre të buta nga jashtë, me 150.3 milionë. Këto flukse kapitali vazhdojnë të mbeten një faktor i rëndësishëm në rritjen e detyrimeve financiare të Shqipërisë me pjesën tjetër të botës.

Kjo rritje ka financuar kryesisht investimet dhe konsumin, dhe është reflektuar në rritje të importeve për konsum si dhe të nevojave për kapital dhe/ose mallra kapitalë të kompanive. Rritja e këtyre detyrimeve ka çuar në rritjen e pagesave të ardhshme të borxhit të jashtëm. Njëkohësisht, shërbimi i borxhit të jashtëm për vitin 2006 ka reduktuar detyrimet tona me rreth 55 milionë euro, duke përfaqësuar vetëm 3 për qind të eksporteve tona gjatë vitit 2006, gjë që tregon për një aftësi paguese brenda niveleve të pranuar. Ndërkohë, huamarrja private duket të ketë ngadalësuar ritmet e rritjes së saj. Krahasuar me vitin 2005, rritja e detyrimeve të këtij sektori vlerësohet sa gjysma e fluksit hyrës të një viti më parë dhe zë vetëm 20 për qind të huamarrjes. Struktura e borxhit të jashtëm, të krijuar nga huamarrja dominohet nga sdr (58 për qind), ndjekur nga monedha evropiane dhe dollari amerikan.

Rritja e këtyre detyrimeve, e cila përbën 43 për qind të flukseve neto të llogarisë financiare, ka financuar kryesisht konsumin e ekonomisë. Kjo është reflektuar edhe në rritje të importeve për të financuar nevojat për kapital dhe/ose mallra kapitalë të kompanive, duke krijuar detyrime të reja në formën e pagesave të ardhshme të borxhit të jashtëm.

Sipas shpërndarjes sektoriale, peshën kryesore në huamarrjen shqiptare e zë huamarrja qeveritare dhe ajo shtetërore e garantuar, përkatësisht me 67 për qind dhe 33 për qind, të cilat së bashku në fund të vitit 2006 u rritën me 118 milionë euro. Shqipëria, deri në fund të këtij viti, ka një borxh të jashtëm shtetëror prej 1.057 miliardë eurosh dhe një borxh publik të garantuar prej 180 milionë eurosh.

Niveli i borxhit të krijuar nga huamarrja vlerësohet në rreth 18 për qind e PBB-së. Ky borxh si stok detyrimesh për frymë, paraqitet relativisht i ulët krahasuar me vendet e tjera të rajonit dhe mbetet brenda kufijve të zgjidhshmërisë së tij.

Struktura e borxhit të jashtëm sipas monedhave, mbizotërohet nga sdr (rreth 36 për qind) e ndjekur nga monedha evropiane, euro (21 për qind), dollari amerikan (16 për qind) dhe monedha të tjera (28 për qind).

Pagesat e interesit dhe principalit (shërbimi i borxhit të jashtëm) të krijuar nga huamarrja nga jashtë, vlerësohen në nivele modeste, duke arritur në rreth 11 për qind të totalit të eksporteve gjatë vitit 2006. Arrihet në përfundimin se



Shqipëria nuk është në prag të ballafaqimit me aftësi paguese të borxhit të jashtëm, të krijuar nga huamarrja.


Mjetet financiare të Shqipërisë ndaj pjesës tjetër të botës janë rritur me 148 milionë euro ose rreth 7 herë më të larta se një vit më parë. Mjetet valutore, të zotëruara nga sistemi bankar në formën e depozitave jashtë, të cilat zënë peshën kryesore të kësaj rritjeje, vlerësohen me rritje (rreth 157 milionë) kundrejt rënies së vitit të kaluar. Në përbërjen e tyre, 55 për qind zënë këto mjete në dollarë, ndërsa pjesa tjetër është në euro (39 për qind) dhe stërlina angleze (6 për qind). Rritja e këtyre mjeteve ka ardhur si pasojë e rritjes së depozitave të rezidentëve dhe jorezidentëve në sistemin tonë bankar, i cili i ka investuar këto në institucionet financiare jashtë. Njëkohësisht është vënë re edhe një ndryshim i raportit të mjeteve të investimit. Sistemi bankar këtë vit ka preferuar zhvendosjen e mjeteve nga investime portofoli në depozita me jashtë. Kështu, mjetet financiare në formën e investimeve të portofolit regjistrojnë shumë 84.3 milionë euro, duke shënuar një rënie vjetore prej rreth 27 milionë eurosh. Në përbërjen strukturore sipas monedhave, investimet e portofolit gjatë këtij viti mbizotërohen nga ato në dollarë rreth 77 për qind, në euro 16 për qind dhe në stërlinën angleze 7 për qind.

Mbajtja e cash-it në valutë gjatë vitit 2006, ka shënuar një rritje prej 18 milionë eurosh dhe nuk ka shfaqur luhajtje domethënëse. Në përbërjen e tyre sipas monedhave në fund të vitit 2006, këto mjete në dollarë amerikanë zinin 32 për qind, ato në euro 62 për qind dhe stërlina angleze, 5 për qind.

#### 1.4 REZERVAT VALUTORE

Flukset hyrëse të mjeteve valutore në formën e kapitaleve financiare u reflektuan në rritje të Rezervave të Autoritetit Monetar, me rreth 206 milionë euro. Në fund të vitit 2006 rezerva valutore shënoi nivelin 1.3 miliardë euro, duke qenë e mjaftueshme për të mbuluar rreth 4.5 muaj importe mallrash dhe shërbimesh.

Grafik 13. Rezerva valutore në muaj importe.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

## 2. ANEKS

### 2.1 POLITIKA TREGTARE TË SHQIPËRISË

Deri në vitin 1990, Qeveria Shqiptare ushtronte monopolin në tregtinë e jashtme dhe e kontrollonte atë nëpërmjet një mekanizmi drejtues tepër të centralizuar. Deri në atë kohë ekzistonin vetëm 6 sipërmarrje shtetërore që merreshin me tregtinë e mallrave, 5 që mbulonin shërbimet dhe 2 ose më shumë që merreshin me licencat dhe marrëveshjet. Në kuadër të politikave të tregtisë së jashtme, rëndësi e veçantë i jepej eksporteve, duke u përpjekur të mbahej në mënyrë strikte një tregti e balancuar.

Rënia e sistemit të centralizuar solli ndryshime thelbësore në metodat e drejtimit të tregtisë së jashtme. Qeveria braktisi monopolin e tregtisë në gusht të vitit 1990, kur filloi të lejonte sipërmarrjet shtetërore të drejtonin tregtinë e jashtme. Një vit më vonë, kompanitë private shqiptare fituan të drejtën për të bërë tregti me vende të tjera, kur Qeveria Shqiptare vendosi që firmat vendase do të lejoheshin të eksportnin gjithçka, përveç disa artikujve të përcaktuar. Gjithashtu, u vendosën tarifa doganore që varionin nga 10 për qind, për ushqimet deri në 30 për qind, për makineritë dhe pajisjet e reja.

Tashmë, tregtia e jashtme shqiptare është në procesin e liberalizimit. Që nga viti 1994, niveli i tarifës doganore mbi importet u ul nga shkalla më e lartë (40 për qind), në 15 për qind në janar 2001.

Në kuadër të sistemit shumëpalësh të tregtisë, Shqipëria u pranua si anëtare e *Organizatës Botërore të Tregtisë*, në shtator të vitit 2000. Në këtë mënyrë, politikat tregtare të vendit tashmë janë të ankoruara nga sistemi rregullator i tregtisë globale, gjë që i bën këto politika shumë më transparente dhe të besueshme. Në kuadër të anëtarësimit në OBT, vendi ynë u angazhua për një tarifë maksimale prej 20 për qind, ndërkohë që ka ndërmarrë edhe nisma sektoriale, për liberalizimin gradual të tregtisë.

Në kuadër të integritit evropian, në vitin 2003, Shqipëria filloi negociatat me Bashkimin Evropian për nënshkrimin e një Marrëveshjeje Stabilizim-Asociimi (MSA). Autoritetet kanë realizuar një raund teknik negociatash, për kapitujt e tregtisë së mallrave industrialë, si dhe një sërë negociatash tregtare, për mallrat bujqësorë.

Pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Stabilizim – Asociimit (MSA) (në Luksenburg, më 12 dhjetor 2006), zhvillimi dhe forcimi i marrëdhënieve tregtare ndërmjet Shqipërisë dhe shteteve të BE- së, u bë akoma dhe më i nevojshëm. Për këtë qëllim, më 1 dhjetor 2006 hyri në fuqi Marrëveshja e Përkohshme, e cila lejon aplikimin e dispozitave të MSA- së, që lidhen me tregtinë. Ajo zëvendësoi Marrëveshjen për Bashkëpunim Tregtar dhe Ekonomik ndërmjet Shqipërisë dhe BE-së, brenda një periudhe 10-vjeçare. Sipas kësaj marrëveshjeje, taksat doganore për mallrat industrialë shqiptarë që hyjnë në tregun evropian ulen në zero. I njëjti rregull zbatohet për pjesën më të madhe të produkteve bujqësore, ndërkohë që për produktet e tjera, taksat do të vazhdojnë të ulen gradualisht deri në eliminimin e plotë. Zbatimi i standardeve do të jetë gjithnjë e më shumë një faktor përcaktues, për të vendosur se duhet shpenzuar për të arritur nivelin e standardeve evropiane.

*Politika tregtare me vendet e rajonit.* Me inkurajimin e Bashkimit Evropian, vendet e Evropës Juglindore (shtatë prej tyre, respektivisht: Shqipëria, Bosnje-Herzegovina, Maqedonia, Bullgaria, Rumania, Kroacia, Serbia dhe Mali i Zi, duke shtuar më vonë dhe Kosovën në këtë nismë si dhe Moldavinë) kanë nënshkruar që në vitin 2001, një Memorandum Mirëkuptimi për lehtësimin dhe liberalizimin e tregtisë midis tyre. Kjo do të thotë lëvizje e lirë e mallrave dhe shërbimeve, që shoqërohet me shfrytëzim më të mirë të përparësisë krahasuese të vendeve. Objektivi përfundimtar është që, nëpërmjet rrjetit dypalësh të marrëveshjeve të tregtisë së lirë, të krijohet një zonë e tregtisë së lirë mes këtyre vendeve, deri në fillim të vitit 2008.

Me hyrjen në fuqi të Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë me Bosnje-Hercegovinën, në dhjetor të vitit 2004, Shqipëria ka plotësuar kuadrin dypalësh të marrëveshjeve të tregtisë së lirë në rajon.

Krijimi i zonës së lirë tregtare mes vendeve të rajonit prek kryesisht sektorin industrial, ndërsa sektorët e bujqësisë dhe të industrisë së mallrave ushqimorë, në shumë raste parashikojnë hapje të pjesshme e graduale ose ruajtje të regjimit aktual tregtar.

*Marrëveshjet dypalëshe.* Në kuadrin e Memorandumit të Mirëkuptimit për Lehtësimin dhe Liberalizimin e Tregtisë, të Paktit të Stabilitetit (nënshkruar nga ministrat e tregtisë të vendeve të Evropës Juglindore në Bruksel, në qershor 2001), Qevera Shqiptare u angazhua për zbatimin e politikave liberale të tregtisë. Një ndër kërkesat e Paktit të Stabilitetit është që Ballkani të transformohet në një zonë tregtare të lirë. Shqipëria ka nënshkruar marrëveshje dypalëshe me të gjitha vendet pjesëmarrëse në Memorandum, duke përfshirë dhe Kosovën.

Marrëveshja e Tregtisë së Lirë më e fundit, është ajo e nënshkruar ndërmjet Shqipërisë dhe Republikës së Turqisë, në 21 dhjetor 2006. Kjo është një marrëveshje asimetrike, në bazë të së cilës mallrat shqiptarë që eksportohen në Turqi nuk do t'i nështrohen taksave doganore. Në të njëjtën mënyrë, tarifat për mallra industrialë të veçantë, të importuar nga Turqia do të vazhdojnë të ulen dhe do të eliminohen pas 5 vjetësh.

Aktualisht, Marrëveshjet e Tregtisë së Lirë me Bullgarinë dhe Rumaninë janë eliminuar që prej momentit që ato u bënë shtete anëtare të BE- së, dhe tani me to do të aplikohet Marrëveshja e Përkohshme. MTL-të me vendet e tjera të rajonit, me përjashtim të Turqisë, do të hiqen me hyrjen në fuqi të CEFTA- s, në maj të 2007- ës.<sup>6</sup>

*Marrëveshja e tregtisë së lirë e Evropës Qendrore.* Në 6 prill 2006, u nënshkrua një deklaratë e përbashkët për shtrirjen e CEFTA-s në Shqipëri, Bosnje-Hercegovinë, UMNİK për Kosovën, Moldavi, Serbi dhe Mal i Zi, në Samitin e kryeministrave të Evropës Juglindore, të mbajtur në Bukuresht. Anëtarët aktualë të CEFTA- s janë Kroacia dhe ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë. Marrëveshja e zgjeruar u iniciua më 9 nëntor 2006, në Bruksel dhe u nënshkrua më 19 dhjetor 2006. Ratifikimi do të realizohet përpara 31 marsit 2007 dhe Traktati i ri i CEFTA-s do të hyjë në fuqi, në 1 maj 2007. CEFTA e zgjeruar do të konsolidojë rrjetin dypalësh të marrëveshjeve të tregtisë së lirë dhe do të sigurojë që Shqipëria të jetë një partner i barabartë brenda CEFTA-s. Ajo do t'u sigurojë eksporteve shqiptare akses pa taksa në një treg të madh. Gjithashtu, do të krijojë dhe institucione të përbashkëta, për të nxitur më tej zhvillimin ekonomik dhe për të trajtuar barrierat e tregtisë në mënyrë bashkëpunuese. Përgatitja e një tregu të hapur midis vendeve të rajonit, do ta bëjë të aftë vendin të kërkojë nesër integrimin në ekonominë evropiane, pjesë e së cilës çdo vend i rajonit aspirojnë të jetë.

## 2.2 ANALIZA E VROJTIMIT TË TURIZMIT PËR VITIN 2006

Turizmi në bilancin e pagesave përfshin transaksionet e kryera gjatë udhëtimit apo qëndrimit të individëve jashtë vendit të zakonshëm për më pak se një vit, për qëllime biznesi ose personale<sup>7</sup>.

Vrojtimi i turizmit daton që prej vitit 1999, i ndërmarrë prej Sektorit të Bilancit të Pagesave, për hartimin e statistikave të shërbimeve të udhëtimit. Ky vrotim ka gjetur përdorim të drejtpërdrejtë në bilancin e pagesave, duke mundësuar vlerësimin e të ardhurave dhe shpenzimeve për udhëtime.


### 2.2.1 METODOLOGJI

Metodologjia e vrotimit paraqitet si më poshtë:

- Vrojtuesi-Banka e Shqipërisë.
  - Intervistuesi-intervistuesi në terren, nën drejtimin e INSTAT.
  - Mënyra e anketimit-intervistimi në terren.
- a) Qëllimi i vrotimit - Qëllimi kryesor i këtij vrotimi është mbledhja e informacionit mbi ditëqëndrimin mesatar dhe shpenzimet mesatare ditore të turistëve rezidentë dhe jorezidentë, gjatë udhëtimeve të tyre përkatësisht jashtë dhe brenda Shqipërisë. Informacionet e tjera të marra nga ky vrotim, shërbejnë për qëllime analize. Vrojtimi i turizmit

- mbulon një pjesë të konsiderueshme të pikave kufitare, karakteristikat e secilit grup të intervistuar, qëllimin e vizitës, ditëqëndrimin si dhe shpjegon, shpenzimet e kryera në periudha të ndryshme të vitit.
- b) Përcaktimi i popullatës dhe i pikave të intervistimit - Popullata që synohet të mbulohet nëpërmjet këtij vërtetimi, përbëhet nga dy grupe. Njëri është grupi i udhëtarëve rezidentë<sup>8</sup>, që kthehen nga udhëtimi jashtë shtetit për qëllime turizmi dhe tjetri; është grupi i udhëtarëve jorezidentë, që largohen nga Shqipëria pas një udhëtimi turistik. Intervistimi kryhet në pikat kufitare të Republikës së Shqipërisë. Këto pika janë përcaktuar, bazuar në të dhënat e marra nga Ministria e Brendshme mbi numrin e hyrje-daljeve, në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- c) Vëllimi i zgjedhjes për intervistim - Zgjedhja e popullatës për vërtetim përcaktohet nisur nga regjistrimet e Ministrisë së Brendshme mbi fluksin e hyrje-daljeve në pikat kufitare të Republikës së Shqipërisë. Për përcaktimin e vëllimit të zgjedhjes për çdo pikë kufitare, kemi përdorur metodën e zgjedhjes tipike proporcionale, si mënyra më e përshtatshme për rastin tonë me të dhëna të grupuara. Vërtetimi ndërmerret me frekuencë tremujore, me një vëllim zgjedhjeje prej 1000 individësh për tremujor, prej të cilëve 500 udhëtarë rezidentë intervistohen në momentin e kthimit nga udhëtimi jashtë dhe 500 jorezidentë intervistohen në momentin e largimit nga Shqipëria.
- d) Përpunimi i të dhënave - Hedhja dhe përpunimi i të dhënave realizohen pranë Departamentit të Statistikës, në Bankën e Shqipërisë. Para se të fillojë përpunimi, bëhet pastrimi i të dhënave nga vlerat ekstreme si edhe përlllogaritja në euro e shpenzimeve mesatare ditore. Përpunimi i të dhënave bëhet sipas pikave kufitare, për të llogaritur peshën specifike për secilin grup udhëtarësh.

Grafik 1. Ecuria e rritjes vjetore të numrit të jorezidentëve dhe rezidentëve në tremujorë.




Burimi: Ministria e Brendshme.

## 2.2.2 ANALIZA E REZULTATEVE

- Numri i udhëtarëve

Numri i udhëtarëve të regjistruar në pikat kufitare ka njohur rritje në terma absolutë gjatë vitit 2006, në krahasim me një vit më parë. Në grafikun 1, jepet rritja vjetore e fluksit hyrës dhe dalës gjatë tremujorëve të vitit 2006, kundrejt vitit 2005. Ndërsa, vërehet një rritje e vazhdueshme e numrit të rezidentëve që kanë udhëtuar jashtë, norma e rritjes së fluksit hyrës ka ndjekur luhajtje sezonale, duke arritur pikun më të lartë prej 31 për qind, në tremujorin e tretë. Ndërkohë, për rezidentët gjatë vitit 2006, në krahasim me një vit më parë

Grafik 2. Shpërndarja e rezidentëve dhe jorezidentëve sipas shteteve.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

përqendrimi më i madh i udhëtimeve është vërejtur gjatë tremujorit të katërt (rritje vjetore prej 39 për qind).

Bazuar në vëllimin e zgjedhjes së vrojtimit, më poshtë paraqitet shpërndarja sipas shteteve, për destinacionin e udhëtimit në rastin e rezidentëve dhe vendin e origjinës, në rastin e jorezidentëve, të intervistuar në pikat kufitare. Më poshtë, është dhënë tabela e shpërndarjes së popullatës totale të jorezidentëve sipas shteteve, e llogaritur mbi të dhënat e regjistruara në pikat kufitare.


Tabelë 1. Shpërndarja e jorezidentëve sipas shteteve në vite dhe ndryshimi vjetor për vitin 2006 (në përqindje).

	Pesha ndaj totalit të vizitorëve jorezidentë			Rritja vjetore (2006/2005)
	2004	2005	2006	%
Total	100.0	100.0	100.0	31.4
Vendet e BE-15	26.4	27.0	26.0	32.1
Itali	8.0	7.8	6.9	21.3
Greqi	6.3	6.1	5.6	26.7
Britani e Madhe	4.8	4.7	5.4	59.4
Gjermani	2.9	3.2	3.0	26.5
Francë	1.1	1.4	1.4	35.1
Vendet e Evropës Juglindore	65.3	63.6	60.8	31.4
Kosovë	32.6	28.8	26.4	26.1
Maqedoni	15.5	19.0	19.9	43.7
Mali i Zi	8.6	7.6	7.0	26.1
Serbi	5.1	4.5	4.1	26.1
Turqi	1.8	1.8	1.4	8.1
Vende të tjera	8.3	9.4	13.2	37.5

Burimi: Ministria e Brendshme.

Rreth 61 për qind e fluksit hyrës ka ardhur kryesisht nga vendet e Evropës Juglindore, 26 për qind nga vendet e Bashkimit Evropian dhe 13 për qind nga vende të tjera. Pjesa më e madhe e vizitorëve nga Bashkimi Evropian përbëhet nga Italia (7 për qind), Greqia (6 për qind), Gjermania (3 për qind) ndërsa rajoni përfaqësohet me shtetasit nga Kosova (26 për qind), Maqedonia (20 për qind), Mali i Zi (7 për qind).

Grafik 3. Shpërndarja e rezidentëve dhe jorezidentëve sipas qëllimit të udhëtimit.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Pavarësisht se Bashkimi Evropian përbën rreth 80 për qind të destinacioneve kryesore të rezidentëve, vendet më të frekuentuara mbeten Greqia (37 për qind) dhe Italia (28 për qind). Fluksi prej 20 për qind ndaj totalit të rezidentëve, rezulton i shpërndarë drejt vendeve të rajonit, kryesisht në Kosovë (7 për qind), në Mal të Zi (4 për qind), Maqedoni (5 për qind) dhe Turqi (3 për qind). Analiza e mësipërme e shpërndarjes së udhëtarëve sipas shteteve, na jep dhe përbërjen e shportës së valutës hyrëse dhe dalëse, në të cilën kryesojnë euro, paundi britanik dhe dollari amerikan.

Turizmi në Shqipëri karakterizohet nga sezonaliteti, i cili ndikon si qëllimin e udhëtimit ashtu dhe shpenzimet e kryera. Gjatë gjysmës së parë të vitit, 40 për qind e jorezidentëve kanë ardhur për qëllime

biznesi ndërsa gjatë gjysmës së dytë të vitit, rreth 70 për qind kanë ardhur për pushime.

Gjatë tërë vitit, rezidentët shqiptarë kanë udhëtuar jashtë kryesisht për qëllime personale, në 70-80 për qind të rasteve të vrojtuar. Ndërkohë, intervali 20-30 për qind përfaqëson rezidentët që kanë udhëtuar për qëllime biznesi. Siç vihet re për të dyja grupet e udhëtarëve, mesatarisht 65 për qind udhëtojnë në rrugë tokësore, 20 për qind në rrugë detare dhe 15 për qind në rrugë ajrore. Grafiku tregon se rezidentët gjatë këtij viti kanë preferuar të udhëtojnë më shumë në rrugë tokësore dhe më pak në rrugë detare, në krahasim me vitin 2005.


- Ditëqëndrimi

Ditëqëndrimi i rezidentëve që kanë udhëtuar jashtë, krahasuar me një vit më parë ka rënë për kategorinë personale dhe është rritur për atë biznes. Për qëllime personale, qëndrimi luhatet tek 10 ditë, ndërsa për qëllime biznesi luhatja gjatë tremujorëve për vitin 2006 ka qenë në intervalin 5 deri në 6 ditë, në krahasim me intervalin prej 3 deri në 4 ditë, të një viti më parë. Ndërkohë që të huajt, në krahasim me një vit më parë, kanë qëndruar 2 ditë më pak për qëllime personale dhe 1 ditë më shumë për arsye biznesi. Kështu, jorezidentët kanë qëndruar mesatarisht 5 ditë për biznes dhe 11 ditë për qëllime personale.

Mund të themi se ditëqëndrimi për të dyja grupet e udhëtarëve, rezidentë dhe jorezidentë, kushtëzohet nga periudhat sezonale të vitit. Kështu, në tremujorët e tretë dhe të katërt vërehet ditëqëndrimi më i lartë. Gjithashtu, në këta tremujorë haset dhe fluksi më i lartë i udhëtarëve si në hyrje dhe në dalje.


Ndërkohë, që ditëqëndrimi për qëllime personale është më i lartë se ai për qëllime biznesi (shiko grafikun 5).

Grafik 4. Shpërndarja e udhëtarëve rezidentë dhe jorezidentë sipas mënyrës së udhëtimit.



Burimi: Ministria e Brendshme.


Grafik 5. Ditëqëndrimi mesatar për rezidentët dhe jorezidentët sipas qëllimit të udhëtimit dhe sipas tremujorëve 2004-2006.




Burimi: Banka e Shqipërisë.

- Shpenzimet mesatare ditore

Në krahasim me vitin 2005, shpenzimet mesatare në ditë për qëllime personale janë rritur me 12 për qind, për të dyja grupet e udhëtarëve.



Kështu, rezidentët kanë shpenzuar për qëllime personale në intervalin 65-80 euro në ditë kundrejt atij prej 63-75 eurosh në ditë, të vlerësuar një vit më parë. Gjithashtu, edhe jorezidentët kanë shpenzuar mesatarisht 75 euro në ditë në krahasim me shpenzimet mesatare prej 68 eurosh të një viti më parë. Ndërsa, shpenzimet mesatare për qëllime biznesi kanë rënë në masën 9 për qind. Këto shpenzime paraqiten në luhatje tremujore, prej 90 deri në 110 euro në ditë dhe 100 deri në 120, respektivisht për rezidentët dhe jorezidentët. Piku më i lartë i shpenzimeve është vërejtur në tremujorin e katërt, i cili ka përkuar edhe me flukset e larta të udhëtarëve.





Grafiku 7 paraqet strukturën e shpenzimeve dhe peshën që ato zënë në buxhetin e udhëtarëve rezidentë dhe të atyre jorezidentë. Për t' i bërë të krahasueshme, në pjesën e jorezidentëve i kemi përjashtuar shpenzimet e kryera nga jorezidentët me kombësi shqiptare, duke pasur parasysh që këta të fundit shfrytëzojnë mundësinë e akomodimit tek të afërmit. Siç vihet re, për rezidentët shqiptarë, një peshë të moderuar e zënë shpenzimet për akomodim (8 për qind) dhe ushqim (10 për qind), ndërsa peshën më të madhe e zënë blerjet e tjera (82 për qind). Udhëtarët e huaj vazhdojnë të ruajnë të njëjtën prirje në shpenzime, të vërejtur në vitet e mëparshme, ku rreth 60 për qind shkon për shpenzime akomodimi dhe ushqimi, ndërsa pjesa tjetër për shpenzime të ndryshme.

### 3. ANEKS METODOLOGJIK

#### *Jorezident:*

Do të konsiderohet çdo individ, ndërmarrje apo organizatë e vendosur në një vend tjetër jashtë Shqipërisë. Bankat që operojnë në shtete të tjera janë shembuj të jorezidentëve. Personat, të cilët nuk jetojnë zakonisht (për një periudhë kohore më shumë se një vit) në Shqipëri, janë gjithashtu jorezidentë.

#### *Rezident:*

Konsiderohen të gjitha ndërmarrjet që operojnë në Shqipëri, pavarësisht nëse ato janë pronë e personave shqiptarë apo të huaj. Personat që zakonisht jetojnë në Shqipëri konsiderohen, gjithashtu, rezidentë, pavarësisht nga shtetësia apo kombësia e tyre. Një përjashtim nga ky rregull janë personelet e huaja, të vendosura në ambasadat e akredituara në Shqipëri. Këta konsiderohen jorezidentë. Në përgjithësi, në rast se është e vështirë të përcaktohet rezidenca e një subjekti do të gjykohet duke u mbështetur në periudhën që ai operon në Shqipëri. Nëse kjo periudhë është më e gjatë se 1 vit, subjekti do të konsiderohet rezident.

#### *Import i mallrave:*

Konsiderohet procesi i kalimit të pronësisë së mallrave të lëvizshëm (me disa përjashtime) nga një jorezident tek një rezident.

#### *Eksport i mallrave:*

Konsiderohet procesi i kalimit të pronësisë së mallrave të lëvizshëm (me disa përjashtime) nga një rezident tek një jorezident.

#### *Bilanc tregtar:*

Paraqet diferencën ndërmjet eksporteve dhe importeve. Nëse kjo diferencë është pozitive ose negative, atëherë kemi të bëjmë përkatësisht me suficit ose deficit tregtar.

#### *Klasifikimi STIC:*

